

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane ngre alarmin: Evropa rrezikon të mbetet peng i SHBA-së dhe Kinës për inteligjencën artificiale
ADRESA	https://piranjat.al/bota/presidentja-e-bankes-qendrore-evropiane-ngre-alarmin-evropa-rre-zikon-te-mbe-i104177
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:52:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:41:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e9a7e764c57c91b7f6766ce52c652e6544a37a281d3603cb9110096b6137f530
TEKSTI	4faff2a8a20ee4e3676827a67e18475d7bd2ef51bb85bb69288b53c08e3728e9
PAMJA	b67ba460d2c5de4c9029909639d5be4739eff2aa527a8561d45efb35b34d797e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c3443434afceac8e76eb0143bb0a9e5e53c375b4fb312345d4a7e1a0052c2a38
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9887a58f034e5892caf63e36ccbe81dcf86c1b224001923b84c66783530d965e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c3443434afceac8e76eb0143bb0a9e5e53c375b4fb312345d4a7e1a0052c2a38

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: Avdyaj dhe Morina, Aldo Avdyli, me burg te përjetshëm, absurdi se si sjana per dy arratisje spektakolare nga burgjet, silleen njerez për ta shkatërruar e të Shqipërisë, duket se prapaskenat e kalimit te Barcelona: shtynë të zgjedhë Barcelonën, kunder ngadalësimit të ritmit: Ide artificia

BOTA

Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane ngre alarmin: Evropa rrezikon të mbetet peng i SHBA-së dhe Kinës për inteligjencën artificiale

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 09:41



Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane, Christine Lagarde, ka paralajmëruar se Evropa duhet të zhvillojë modelet e veta të inteligjencës artificiale dhe të forcojë ndjeshëm infrastrukturën e saj të qendrave të të dhënave, për të shmangur një varësi të rrezikshme nga Shtetet e Bashkuara dhe Kina. Në një fjalim në Vjenë, Lagarde tha se kontinenti duhet të ndërtojë kapacitete dixhitale autonome, të afta për të përmbushur nevojat e ekonomisë evropiane.

Sipas saj, BE-ja ndodhet përballë një "zgjedhjeje të vështirë". Nga njëra anë, vonimi i përdorimit të inteligjencës artificiale për të mbrojtur të dhënat personale mund të dëmtojë rritjen ekonomike, ndërsa nga ana tjetër, adoptimi i shpejtë i teknologjisë pa ndërtuar kapacitete të veta mund ta bëjë Evropën tërësisht të varur nga kompanitë dhe teknologjitë e huaja. Lagarde iu referua edhe shifrave për të ilustruar hendekun teknologjik. Vitin e kaluar, SHBA-ja zhvilloi 59 modelet të rëndësishme të inteligjencës artificiale, ndërsa Kina 35. Në të njëjtën periudhë, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar zhvilluan nga një model secila.

Edhe sa i përket infrastrukturës kompjuterike, diferenca është e madhe. Shtetet e Bashkuara zotërojnë rreth 75% të kapacitetit kompjuterik botëror të ofruar nga qendrat e të dhënave, ndërsa Evropa vetëm rreth 5%. Sipas paralajmërimit të Lagarde, ky hendek mund të zgjerohet më tej gjatë dekadës së ardhshme nëse kontinenti nuk ndërmerr masa urgjente.

Rreziku bëhet edhe më i madh për shkak të rolit që inteligjenca artificiale pritet të ketë në ekonominë dhe jetën e përditshme. Sipas Lagarde, në vitet e ardhshme AI mund të përdoret për kontrollin doganor në kufij, për përgatitjen e deklaratave tatimore, organizimin e orareve të trenave, monitorimin e pacientëve në spitale dhe kryerjen e transaksioneve bankare. Në këto kushte, ndërprerja e aksesit në teknologjitë kryesore të AI-së ose ndryshimi i kushteve të përdorimit do të mund të shkaktojë pasoja të menjëhershme në sektorë të shumtë të ekonomisë evropiane. Varësia teknologjike, sipas presidentes së BQE-së, mund të kthehet gjithashtu në një mjet presioni në negociatat tregtare dhe ekonomike. Paralajmërimi vjen në një kohë kur marrëdhëniet mes BE-së dhe SHBA-së janë përballur me pasiguri të reja politike, përfshirë debatet për tarifatat tregtare, pretendimet amerikane lidhur me Groenlandën dhe çështjet e sigurisë dhe angazhimit ushtarak.

Pavarësisht potencialit të inteligjencës artificiale për të rritur produktivitetin evropian me rreth 4% gjatë dekadës së ardhshme, Lagarde kërkon që Evropa të mos e shohë këtë teknologji vetëm si një mundësi ekonomike, por edhe si çështje të sovranitetit strategjik. Sipas saj, forcimi i kapaciteteve vendase në AI dhe ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme janë thelbësore që kontinenti të mos mbetet i pambrojtur përballë ndryshimeve të politikës dhe tregjeve globale.

Artikuj te sugjeruar

Nga Ron Bouso BOTA 15 Shtator09:30

Armëpushimi energjetik i Trumpit në Ukrainë nuk do ta zgjidhë krizën globale të naftës

Një armëpushim në infrastrukturën energjetike që Presidenti i SHBA-së Donald Trump arriti midis Rusisë dhe Ukrain...

BOTA 15 Shtator09:23

Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa dhe dronë

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

BOTA 15 Shtator09:07

Rusia godet stacionin e benzinës dhe depot në kryeqytetin e Ukrainës

Një dron goditi një pikë karburanti në Kiev gjatë orëve të para të mëngjesit, njoftoi kryebashkiaku i kryeqytetit...

BOTA 15 Shtator08:55

Trump, ultimatum për "AI", presidenti amerikan kundër ngadalësimit të ritmit: Ide kineze, duhet të dominojmë ne

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka minimizuar rreziqet që paraqet inteligjenca artificiale, pas disa ditësh paralajmërimesh të forta ng...

BOTA 15 Shtator08:39

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënimet kryesore

Shtetet e Bashkuara kanë konfirmuar për herë të parë publikisht se disponojnë armë të vendosura në orbitë, t...

BOTA 15 Shtator08:09

Frikë nga zhvillimi i pakontrolluar i Inteligjencës Artificiale, bien aksionet në bursa

Thirrjet e drejtuesve të industrisë së inteligjencës artificiale për të ngadalësuar zhvillimin e teknologjisë kanë...

BOTA 15 Shtator08:02

Rrëzohet një avion në Gjermani, humbin jetën 3 persona

Tre persona kanë humbur jetën pas rrëzimit të një avioni të vogël në landin Nordrhein-Westfalen të Gjermanisë...

BOTA 15 Shtator08:01

Dyshohet se hyri në Lituani nga Bjellorusia, NATO rrëzon një dron

Një avion luftarak i NATO-s rrëzoi një mjet ajror pa pilot në Lituani pak pas mesnatës, bwri me dije Qe...

BOTA 15 Shtator07:47

Befason SHBA: Kemi vendosur armë në hapësirë

Shtetet e Bashkuara kanë konfirmuar për herë të parë se kanë vendosur një armë hapësinore në orbitën e ...

BOTA 14 Shtator23:09

Zelensky: SHBA-ja duhet të sigurohet se Rusia është vërtet gati para se Ukraina të pranojë propozimin

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka deklaruar se Ukraina është e gatshme të mbështesë një hap drejt uljes së tensioneve...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

FOTO- 'Mos u kthe më në Shqipëri'/ Edi Rama sul..

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl..

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

POLITIKE 14 Shtator

[“Rama u tmerrua në sarajet e Surrelit” – Berish...](#)


Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka zhvilluar një konferencë për mediat pas rikthimit nga vizita e tij në Shtetet e Bashkuar...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.